Referuar kërkesës për informacion drejtuar Koordinatorit për të Drejtën e Informimit më datë 23.09.2026 nga Znj. Elira Kadriu bëjmë me dije si vijon:

Pika 1: Sa është shuma totale e shpenzuar nga viti 2017 deri më sot për krijimin, mirëmbajtjen dhe promovimin e Platformës së Bashkëqeverisjes "Me ty për Shqipërinë që duam"?

Nga buxheti i Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje (ADB) nuk është përballuar asnjë shpenzim për krijimin, mirëmbajtjen apo promovimin e Platformës së Bashkëqeverisjes "Me ty për Shqipërinë që duam".

Në këtë kuadër, ADB ka rolin e porositësit, ndërsa Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) është institucioni përgjegjës për realizimin e shërbimit lidhur me krijimin dhe mirëmbajtjen e sistemit.

Sa i përket promovimit të Platformës, ai realizohet nëpërmjet kanaleve zyrtare të komunikimit dhe rrjeteve sociale të ADB-së, pa kosto financiare të veçantë.

Pika 2: Përveç fondit prej 25 milionë lekësh të akorduar për Këshillimin Kombëtar 2022, a pati shpenzime të tjera nga ADB apo institucione të tjera publike? Nëse po, sa ishte vlera e tyre?

Po, përveç fondit prej 25,000,000 (njëzet e pesë milionë) lekësh, të akorduar për programin e "Këshillimit Kombëtar" në vitin 2022, janë alokuar edhe fonde të tjera për financimin e këtij programi. Konkretisht:

Me Vendimin nr. 81, datë 24.12.2021, "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2021, miratuar për Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, për financimin e programit të 'Këshillimit Kombëtar'", buxhetit të ADB-së iu shtua fondi prej 40,000,000 (dyzet milionë) lekësh, i cili iu transferua Postës Shqiptare, në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit për Zhvillimin dhe Monitorimin e Programit të "Këshillimit Kombëtar", nr. 652 prot., datë 31.12.2021.

Gjithashtu, me Vendimin nr. 769, datë 26.12.2023, "Për një shtesë fondi nga Fondi Rezervë në buxhetin e vitit 2023, miratuar për Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje", janë shtuar fonde në shumën 43,500,000 (dyzet e tre milionë e pesëqind mijë) lekë, për financimin e programit të "Këshillimit Kombëtar", të cilat iu transferuan Postës Shqiptare, në zbatim të Marrëveshjes Paraprake të Bashkëpunimit nr. 781 prot., datë 25.10.2023. Në dijeni në tonë ky shërbim nuk është realizuar.

Pika 3: Sa është buxheti i parashikuar për krijimin, promovimin dhe mirëmbajtjen e "Pasqyrë Albania" dhe cilat institucione do ta financojnë?

Aktualisht, në buxhetin e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje nuk rezulton të jetë parashikuar fond për krijimin, promovimin dhe mirëmbajtjen e "Pasqyrë Albania".

Gjithashtu, ADB nuk disponon informacion lidhur me institucionet që do të financojnë këtë platformë.

Pika 4: Sa ankesa/kërkesa janë depozituar në Platformën e Bashkëqeverisjes nga viti 2017 deri më sot dhe sa prej tyre rezultojnë të zgjidhura? Ju lutem, të dhënat të paraqiten sipas viteve dhe, nëse disponohen, sipas institucioneve.

Përsa i përket aktivitetit të Platformës së Bashkëqeverisjes, në lidhje me ankesat/kërkesat e regjistruara, trajtuara dhe zgjidhura, lutem referohuni link të mëposhtëm, ku gjeni të publikuara online të gjitha të dhënat statistikore, të detajuara në vite:

https://adb.gov.al/programi-i-transparences/